



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.330/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Deric dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Gentiana Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve të kandidatëve të tyre në vende publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.02.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.330/2021 e datës 04.02.2021, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), t'i shqiptohet gjobë për shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e vendosjes së posterit/bilbordit në pjesën e jashtme të ndërtesës publike.

A r s y e t i m

Më datë 04.02.2021, subjekti politik nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se në konviktin e studentëve në Prishtinë është vendosur një poster i kandidates për deputete nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Me këtë paraqitësi i ankesës ka pretenduar se ky veprim i subjektit politik AAK është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, respektivisht nenin 33 pika B të këtij ligji, po ashtu ka shtuar se ky veprim paraqet shkelje të nenit 3 pika 3.2. të Rregullave Zgjedhore Nr.01/2012.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të posterit të kandidates për deputete Meliza Haradinaj nga subjekti politik AAK.

PZAP-i, më datë 04.02.2021, konform nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, njoftoi subjektin politik AAK, për ankesën e paraqitur, duke i dhënë kohë për përgjigje deri më datë 05.02.2021 në ora 12:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 05.02.2021, subjekti politik AAK thekson se vendosja e këtij posterit nuk përbën shkelje sepse hapësira në fjalë është e projektuar për reklama.

Paraqitësi i përgjigjes në ankesë në mbështetje të pretendimeve të tij, si dëshmi ka bashkangjitur foto të reklamave të mëhershme të vendosura në këtë hapësirë, kontratën e qirasë mes N.SH. "2B" dhe Qendrës së Studentëve për qira të hapësirave reklamuese nr.171 e dt. 13.11.2020 si dhe Vendimin e PZAP A231/19.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar,

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Organizata BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë PZAP A.nr 330/2021 më datë 04.02.2021, me të cilën pretendon se posteri/billbordi i kandidates për deputet nga radhët e Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Meliza Haradinaj Stublla, është vendosur në institucion publik.

Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit politik AAK për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik AAK me datë 05.02.2021, ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tersi pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë dhe duke kërkuar që ankesa të refuzohet e pa bazuar, për shkak se hapësira në fjalë edhe më herët është shfrytëzuar për reklamim, e njëjta menaxhohet nga kompania N.Sh "2B" dhe kanë të drejtë vendosjen e posterave apo billbordve, pikërisht duke u mbështetur nga këto theksime.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstatoi se nga ana e subjektit politik AAK nuk është bërë shkelje e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri i kandidates për deputete nga subjekti politik AAK është vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterëve.

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje të Rregullave Zgjedhore Nr.01/2012 nga subjekti politik AAK pasi që posteri në fjalë është i vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre, ashtu siç vërtetohet edhe nga fotografitë dhe provat tjera materiale të bashkangjitura ankesës nga pala ankuuese që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.330/2021 më datë 06.02.2021

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.